



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	15.03.2018	Dep. DPK	Nr. Prot. 03-03/842/18
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-782/18	Dep. 03	Br. Prot. 15-03-2018
PËR/ZA/TO:	z. Liridon DALIPI Drejtor i zyrë së Prokurimit Radio Televizioni i Kosovës (RTK)	PRISHTINË	
CC:	z. Mentor Shala Drejtor i Përgjithshëm i Radio Televizionit të Kosovës		
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Servera për nevojat e RTK-së” me nr. të prokurimit RTK/18/1269/211, nr. të brendshëm RTK-T/18/058/111.		

I nderuari z. Dalipi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: “Servera për nevojat e RTK-së” me nr. të prokurimit RTK/18/1269/211, nr. të brendshëm RTK-T/18/058/111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: “Servera për nevojat e RTK-së” me nr. të prokurimit RTK/18/1269/211, nr. të brendshëm RTK-T/18/058/111, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 12 mars 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-782/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Servera për nevojat e RTK-së**” me nr. të prokurimit RTK/18/1269/211, nr. të brendshëm RTK-T/18/058/111, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Radio Televizioni i Kosovës (RTK).

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma E-Prokurimi, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike, lloji shërbime, me vlerë të madhe. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që njoftimin për kontratë në nenin III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiarë është kërkuar: “*Operatorët ekonomik duhet të kenë qarkullim në tri vitet e fundit 2014, 2015, 2016 sa dyfishi i ofertës*”, ndërsa tek dëshmia e kërkuara dokumentare është kërkuar: “*Të dëshmohet me deklaratë të ATK-së*”, kërkesë kjo për të cilën Agjencia gjithashtu konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 68 .

Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 68 paragrafi 1. për ta vërtetuar kapacitete ekonomik dhe financiare të operatorëve ekonomik, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomik që të parashitrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. **Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do ti referohen maksimum tri viteve të fundit financiare.** Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Pra në këtë rast nga operatorët ekonomik të cilët janë të interesuar të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit do duhej të kërkohej qarkullimi **për vitet fiskale 2015,2016 dhe 2017.**

Agjenci kundër Korrupsionit, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 27 dhe nenin 68 Gjendja ekonomik dhe financiare të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Agjencia pas trajtimit të dokumentacionit për tenderin me titull: “**Servera për nevojat e RTK-së**” me nr. të prokurimit RTK/18/1269/211, nr. të brendshëm RTK-T/18/058/111, ju njofton me të gjeturat e këtij aktiviteti të prokurimit dhe rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

